KUKU LE LE PËR HOMOSEKSUALET

Nazmi Sfishta - Nazi.

Nazi i "Aurorës" dëshiron t'i zhdukë homoseksualët. Udhëheqësit të shoqatës së homoseksualëve Nazi i duket si "Gay". Për profesorin e Sheriatit, homoseksualizmi është "Ves i poshtër". Ndërsa psikologjia vazhdon ta trajtojë si çështje të ndërlikuar në të cilën gërshetohen faktorët socialë, biologjikë dhe psikologjikë. E vërteta duket të jetë diku në mes. Si gjithmonë.

Vlora Maxhuni

vlora.maxhuni@gazetaexpress.com

Në emisionin e javës së kaluar "Kush o mal", të transmetuar në KTV, mysafirë ishin edhe dy pjesëtarët e grupit "Aurora", Nazmi Sfishta - Nazi dhe Yll Valla. Në mesin e shumë pyetjeve provokative, Shuki parashtroi një pyetje e cila kishte të bënte me një çështje të ndjeshme - homoseksualizmin.

Pyetja ishte: "Çka mendoni për homoseksualët".

Lideri i grupit "Aurora", Nazi u nënvizoj shkurt e shqip: "I kisha zhdukë".

> **"Unë nuk i marr tragjike shumë akuzat që na vijnë, ngase dihet në çfarë shoqërie po jetojmë".**
>
> UDHËHEQËSI I "ELYSIUM"

Fillimisht përgjigja duke jsi e nxituar, mirëpo këngëtari vazhdoi ta elaborojë publikisht urrejtjen e tij për këtë komunitet.

Në një prononcim për "Express", ai e përsëriti qëndrimin e tij tashmë të njohur.

"Unë jam një person që beson në Zot. Homoseksualizmi dhe të gjitha gjërat që janë kundër fesë islame i konsideroj si gjëra të fëlliqura. Po e them edhe njëherë - i kisha zhdukë", u shpreh Nazi për "Express".

Si besimtar i mirëfilltë i fesë islame, Nazi thotë se të gjithë njerëzit në botë janë të pafuqishëm ndaj Zotit, andaj çdo gjë që është në kundërshtim me Zotin është e papranueshme për të. Sidoqoftë, ai nuk i përfillë as teoritë shkencore, të cilat shpesh thonë se homoseksualizmi është gjenetik.

"Unë nuk flas me gjuhë shkencore, gjuhë ku persona të ndryshëm shpeshherë flasin për të përfituar. Unë i besoj vetëm gjuhës së Zotit dhe askujt tjetër", vazhdon Nazi.

Por, çka do të ndodhte nëse për ironi të fatit, djali i Nazit një ditë të bëhej homoseksual? A do ta zhdukte Nazi djalin e vet?

"Nuk ka gjasa që djali im të bëhet homoseksual. Jo, përderisa unë e realizoj këtë të mirë që na e ka dhënë Zoti. Një gjë e tillë s'mund të më ndodh mua", shprehet ai.

Orientimi seksual është zgjedhje e lirë e secilit person. Në vendet e zhvilluara, përcaktimi seksual është pjesë e debatit por në një nivel tjetër. Atje çështja është se a duhet të lejohet martesa e çifteve homoseksuale dhe adoptimi i fëmijëve nga ana e tyre, si dhe përfshirja e homoseksualëve "të deklaruar" në struktura të larta shtetërore dhe në ato fetare.

Në Kosovë shfaqja publike e përfaqësuesve të komunitetit të homoseksualëve është një realitet i paslufës. Rasti i Nazit nuk është hera e parë që qëndrime të tilla adresohen publikisht drejt komunitetit homoseksual të Kosovës, prandaj këtë komunitet kjo nuk e çudit aspak.

"Kam dëgjuar se si është shprehur për homoseksualët anëtari i grupit 'Aurora'. Ndoshta kjo ka qenë armë mbrojtëse e tij. Këngëtari në fjalë, për nga pamja duket si homoseksual.

Unë nuk i marr tragjike shumë akuzat që na vijnë, ngase dihet në çfarë shoqërie po jetojmë, mirëpo estrada kosovare, pikërisht këngëtari i grupit 'Aurora' si artist që është, duhet të jetë më i matur dhe më i rezervuar. Është artist, fytyrë publike", shprehet njëri ndër udhëheqësit e organizatës së komunitetit homoseksual të Kosovës - "Elysium".

> **"Nuk ka gjasa që djali im të bëhet homoseksual. Jo, përderisa unë e realizoj këtë të mirë që na e ka dhënë Zoti. Një gjë e tillë s'mund të më ndodh mua".**
>
> NAZI

Qysh në krijimin e saj, kjo organizatë kishte marrë shumë reagime dhe akuza, bile edhe kërcënuese.

"Ne jemi mësuar me akuza dhe fyerje të të gjitha llojeve. Madje, kur e kemi formuar komunitetin dhe kemi hapur ueb-sajtin për më shumë se një vit e gjysmë kemi marrë vetëm akuza. Kohëve të fundit jo edhe aq shumë. Mirëpo edhe në shoqërinë kosovare, ka shumë njerëz që na përkrahin dhe na mbrojnë. Unë njoh mjaft të tillë", tregon anëtari i kësaj organizate.

> **"Këtë ves duhet ta fshehim, të mbrohemi prej tij, e jo ta aplikojmë".**
>
> PROF. SHEFQET KRASNIQI

Në anën tjetër, Dr. Shefqet Krasniqi, profesor i Sheriatit në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, pohon se homoseksualizmi e çon një popull të tërë në humnerë.

"Homoseksualizmi është haram. Është kundër të gjitha ligjeve qiellore, e deri tek Kur'ani fisnik. Është thyerje e ligjeve të natyrës dhe në kundërshtim të plotë me natyrën e njeriut", shprehet profesor Krasniqi. Ai e quan homoseksualizmin "Ves i poshtër" dhe thotë se sipas Kur'anit, për herë të parë në tokë kjo dukuri ishte paraqitur tek populli i Lutit. Luti kishte qenë i dërguari i Zotit për ta shpëtuar një popull të tërë homoseksualësh. Ai nuk kishe pasur sukses që ta bëjë këtë dhe Zoti "i kishte shkatërruar me gurë xhehenemi".

Sipas profesor Krasniqit, këtë ves duhet ta fshehtin, të mbrohemi prej tij, e jo ta aplikojmë.

Psikologjia bashkëkohore ka një pikëpamje të ndryshme nga religjioni. Hulumtimet tregojnë se është e mundshme që orientimi homoseksual zë fill shumë herët në cikli jetësor, ndoshta edhe para lindjes.

Shoqata Psikologjike Amerikane kundërshton qëndrimin që lesbiket, gejët dhe biseksualët, për shkak të orientimit të tyre seksual të paraqiten si të sëmurë mentalisht.

Kjo shoqatë thekson se homoseksualizmi është dukuri që vjen si një kombinim i faktorëve socialë, biologjikë dhe psikologjikë.

Çështja e (mos)përkrahjes së homoseksualëve ka vjet që është prezente në botë. Natyrisht, në nivele të ndryshme - që nga e drejta për ta shprehur publikisht këtë qëndrim e deri te pjesëmarrja e tyre në udhëheqjen e institucioneve fetare.

Në Kosovë ky debat është ende tabu. Qëndrimet e rralla publike rreth homoseksualizmit shkaktojnë rrëmujë dhe ngjallin debate të ashpra.

Homoseksualëve kosovarë u mbetet të shpresojnë për ditë më të mira. Kundërshtarët e tyre janë të shumtë.